



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 628/5 Prot.

Tiranë, më 23.04.2021

VENDIM

Nr. 63, datë 23.04.2021

PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES SË PRAKTIKËS MËSIMORE  
DHE PRAKTIKËS PEDAGOGJIKE

Mbështetur në nenin 33, pika 3; në nenin 38, pika 1, gërma “d”, të Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH”, Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të UST-së, si dhe Rregulloret e organizimit dhe funksionimit të Njërive Kryesore të UST; Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 23.4.2021

V E N D O S I:

1. Të miratojë Rregulloren e zhvillimit të praktikës mësimore dhe praktikës pedagogjike në UST.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof.Dr. AGRON KASA





---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

**RREGULLORE MBI KRYERJEN E PRAKTIKËS MËSIMORE**

## **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1**

#### **Baza ligjore**

Kjo rregullore mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015, datë 05.10.2015, “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e Universitetit të Sporteve të Tiranës (UST), në Rregulloren e Përgjithshme të UST.

### **Neni 2**

#### **Objekti i Rregullores**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për kryerjen e Praktikës mësimore (këtu Praktikë) nga studentët e UST-se.

### **Neni 3**

#### **Qëllimi i Praktikës**

Praktika synon përvetësimin efektiv të njohurive teknike, praktike dhe etike të profesionit, mënyrat e së cilës përcaktohen nga institucioni prites ku kryhet praktika (më tej shkurt Institucioni), me propozimin dhe bashkëpunimin e Pedagogut udhëheqës.

## **KREU II**

### **ORGANIZMI DHE DREJTIMI I PRAKTIKËS**

### **Neni 4**

#### **Fusha e zbatimit**

1. Kur Praktika parashikohet si pjesë e planeve mësimore dhe ka një numur të caktuar kreditesh, studentët e kanë të detyrueshme pjesëmarrjen dhe kryerjen e plotë të saj.
2. Praktikrat zhvillohen në Institucione sipas profilit të përgatitjes së studentit nën drejtimin e Mentorit Profesional të caktuar nga institucioni prites dhe të Pedagogut të caktuar nga Departamenti për ndjekjen e ecurisë së praktikës nga ana e studentëve.
3. UST ka detyrimin të sigurojë zhvillimin e Praktikës për studentët e tij.
4. Institucioni i kryerjes së Praktikës zgjidhet, propozohet dhe caktohet nga Departamenti.

Institucioni prites, (kur ka mundësi) mund të propozohet edhe nga vetë studenti, në konsultim e aprovim të Departamentit. Në këtë rast studenti paraqet në Departament një kërkesë nga ana e Institucionit, ku prezantohet shprehja e gatishmërisë për të marrë përsipër ndjekjen dhe zhvillimin e Praktikës së studentit/studentëve pranë tyre, përfshirë edhe caktimin e Mentorit Profesional dhe respektimin e plotësimin e gjithë

dokumentave përkatëse në lidhje me kryerjen e praktikës nga ana e studenteve të UST-se.

Departamenti pasi shqyrton kërkesën e më sipërme dhe e vlerëson atë, jep aprovimin tije, në caktimin e studentit për të kryer praktikën pranë Institucionit të propozuar mbi bazën e një akt-marreveshjeje të dyanëshme të lidhur me të.

### **Neni 5**

#### **Detyrimet e studentit**

Studenti duhet:

1. të frekuentojnë të gjitha orët e Praktikës
2. të angazhohet në respektimin e zbatimit të rregulloreve të UST-se, rregullores së brendëshme të Institucionit ku do të zhvillohet Praktika, të kodit të etikës së Institucionit përkatës si dhe rregullat e sigurimit në punë.
3. të ruaj konfidencialitetin e informacionit, si dhe të zbatojë e respektojë gjithë dispozitat e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

### **Neni 6**

#### **Procedura e Kryerjes së Praktikës**

1. Praktikën duhet ta zhvillojnë të gjithë studentët e regjistruar në vitin akademik ku parashikohet ajo, në bazë të Programit mësimor.
2. Praktika zhvillohet nën drejtimin e një Mentori Profesional, person fizik apo juridik që caktohet si udhëheqës nga Institucioni ku do të zhvillohet Praktika.
3. Gjatë kryerjes së Praktikës, Pedagogu i ngarkuar nga Departamenti përkatës për ndjekjen e ecurisë së praktikës, mban lidhje me Institucionin ku ajo kryhet dhe me Mentorin Profesional.
4. Gjatë kryerjes së Praktikës, Mentori Profesional përpilon Raportin e Vlerësimit përfundimtar si edhe Fletë-vlerësimin e praktikantit, të cilat, në zarf të mbyllur me vulë të Institucionit, i jepet studentit ose Pedagogut të ngarkuar për ndjekjen e praktikës, për ta dorëzuar në Departament;
5. Në përfundim të Praktikës studentit i përgatit e dorëzon në Departament Relacionin përmbledhës të Praktikës së kryer, duke e mbrojtur atë para një Komisionit të Vlerësimit të Praktikës të ngritur nga Departamenti

### **Neni 7**

#### **Strukturat Përgjegjëse**

Struktura përgjegjëse për ndjekjen e praktikës profesionale janë:

- a) Autoritetet drejtuese të Departamentit, Fakultetit.
- b) Komisioni i Vlerësimit të Praktikës;
- c) Pedagogu i ngarkuar për ndjekjen e praktikës;
- d) Mentori Profesional.

## **KREU III**

### **DETYRIMET E INSTITUCIONIT DHE TË MENTORIT**

#### **Neni 8**

##### **Detyrimet e Institucionit**

Institucioni i cili merr përsipër zhvillimin e praktikës mësimore duke caktuar një punonjës si Mentor Profesional gjithashtu institucioni prites duhet te siguroje që praktikanti të kryejë me sukses praktikën profesionale nëpërmjet:

1. krijimit të mundësive për praktikantin, në zbatimin e metodave bashkëkohore dhe interaktive;
2. zhvillimit të aftësive dhe shprehive të praktikantit përmes vëzhgimeve, këshillimeve, rekomandimeve, komenteve dhe aktiviteteve të ndryshme;
3. zhvillimit të detyrave sfiduese nga ana e praktikantit për të zgjeruar njohuritë e tij profesionale;
4. ecurisë e praktikës profesionale të praktikantit dhe rezultateve përfundimtare të tij;
5. njohjes së praktikantit me rregulloret e institucionit dhe me formatin e vlerësimit nga Mentori Profesional;
6. mbajtjes së raportit dhe vlerësimit prej Mentorit Profesional, duke shënuar e përshkruar në të veprimtarinë në orët e zhvillimit të praktikës, konstatimet dhe këshillat kryesore për seancat e vlerësimit të praktikantit;
7. plotësimit të fletë-vlerësimit të praktikantit për çdo orë vëzhgimi të planifikuar.

#### **Neni 9**

##### **Detyrimet e Praktikantit**

Praktikanti, gjatë periudhës së praktikës mësimore në institucionin e zhvillimit të saj, është i detyruar e duhet që:

1. të ndjekë programin e praktikës duke respektuar orarin dhe mjedisin e punës;
2. të ndjekë udhëzimet e Mentorit Profesional përkatës;
3. të respektojë kolegët e përgjegjësit e vëndit të punës;
4. të respektojë e zbatojë rregulloren e institucionit;
5. të ketë parasysht e respektojë rregullat e sigurisë në punë;
6. të ruajë konfidencialitetin e informacionit;
7. të respektojë mënyren e sjelljes dhe etikën.

## **KREU IV**

### **VLERËSIMI I PRAKTIKANTIT**

#### **Neni 10**

1. Në përfundim të Praktikës, ndjekjes së plotë të orëve e gjithë detyrimeve të saj, studenti:

- e) dorëzon në zarf të mbyllur e me vulë nga Institucioni përkatës, Raportin e Vlerësimit të përgatitur nga Mentori Profesional;
  - f) përgatit e dorëzon një Relacion përmbledhës të praktikës mësimore të kryer, duke përshkruar në të aktivitetet e proceset e ndryshme ku është aktivizuar e ka marrë pjesë, përfitimin tekniko-profesional që ka patur, etj.;
  - g) mbron para komisionit të provimit të praktikës mësimore, argumenta e tema nga praktika e zhvilluar në bazë edhe të Relacionit përmbledhës që ai ka paraqitur.
2. vlerësohet me note kaluese ose jo-kaluese, duke marrë parasysh :
    - a) Pjësarrjen aktive të tij gjatë frekuentimit të orëve të praktikës mësimore;
    - b) Rezultatin e vlerësimit sipas Relacionit nga Mentorit Profesional;
    - c) Rezultatin e vlerësimit të Relacionit të praktikës mësimore e të mbrojtjes së tij përpara komisionit të provimit të praktikës së ngritur nga departamenti.
  3. Vlerësimi i studentit bëhet me notë.
  4. Studenti që nuk realizon Praktikën, përfshirë edhe procesin e mbrojtjes të saj brenda afatit të caktuar, i krijohet mundësia ta kryejë atë në një periudhë tjetër të përcaktuar nga Departamenti e Dekanati.

**KREU V**  
**DISPOZITA TE FUNDIT**

**Neni 11**

1. Praktika zhvillohet në Institucionet e caktuara nga Departamenti dhe Fakulteti.
2. Të drejtën e interpretimit të kësaj Regulloreje e ka Dekani i Fakultetit dhe Rektori i UST-se
3. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES  
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE SOCIALE DHE TË EDUKIMIT

**PAKETA E PRAKTIKËS  
MËSIMORE/PEDAGOGJIKE**

**PROGRAMI I CIKIT TË \_\_\_\_\_  
TË STUDIMEVE “ \_\_\_\_\_ ”**

**Miratoi**

**D E K A N**

**Miratoi**

**DREJTUESI I DEPARTAMENTIT**

## **Hyrje**

Qëllimi i praktikës mësimore/pedagogjike është të aftësojë studentët si mësues, specialist i edukimit fizik e shëndetësor, duke integruar proceset pedagogjike, didaktike dhe edukative, me krijimin e mundësisë për të zhvilluar përdorimin e njohurive të fituara nga ana teorike, sportive dhe profesionale, në kontekstin praktik profesional në mjediset shkollore dhe sportive të institucioneve të arsimit parauniversitar.

Praktika pedagogjike do të zhvillojë tek studentët një kuptim të qartë për lëndën e edukimit fizik dhe shëndetësor, vlerat e edukimit fizik e sportiv, vendin që ajo zë në shoqërinë e sotme, për të kultivuar ndjenjen e misionit të çmuar si mësues të së ardhmes.

Studentët e këtij cikli studimi do të jenë vëzhgues dhe pjesëmarrës (në varësi të llojit të praktikës mësimore/pedagogjike) të orëve mësimore dhe organizimit të veprimtarive sportive jashtëmësimore.

Praktika mësimore/pedagogjike do të zhvillohet në institucionet e arsimit parauniversitar të mundësuar nga DAR por dhe institucionet private të arsimit, atje ku studentët tanë banojnë.

## **Përshkrimi i praktikës**

- ✓ Praktika do zhvillohet në institucionet e arsimit parauniversitar.
- ✓ Çdo grup mësimor do të ketë si udhëheqës një mësues (Mentor) me përvojë në institucionin arsimor ku do të kryej praktikën.
- ✓ Studenti praktikant do të marrë mbështetjen nga pedagogu drejtues i ngarkuar për ndjekjen e praktikës.
- ✓ Studenti do të plotësojë të gjitha detyrimet e kërkesat e programit mësimor të praktikës.
- ✓ Studenti është i detyruar të paraqesë një figurë të pastër model e të plotësojë të gjitha kërkesat që Dispozitat Normative shtrojnë për një mësues të arsimit parauniversitar.
- ✓ Vlerësimi studentit do të bëhet sipas tabelave bashkëngjitur.

## **Zhvillimi i praktikës**

Praktika mund të zhvillohet në institucionet e arsimit parauniversitar në Tiranë, por edhe jashtë saj atje ku studentët banojnë.



Studenti duhet të kontaktojë pedagogun drejtues të ngarkuar për ndjekjen e praktikës lidhur me kohën e zhvillimit të praktikës. Studenti praktikant do të marrë vetë kontakte me institucionin arsimor të përcaktuar.

### **Vlerësimi i praktikës**

Vlerësimi përfundimtar (bëhet nga komisioni i ngritur nga departamenti përgjegjës) është procedura që kryhet në përfundim të praktikës dhe përmban vlerësimin e relacionit të hartuar nga studentit, vlerësimin e 5 (pesë) planeve tematike të hartuara nga studentit sipas temave mësimore të marra nga kurrikula e arsimit parauniversitar, vlerësimi i mësuesit mentor të institucionit ku ka kryer praktikën si dhe vlerësimin e pedagogut drejtues të ngarkuar për ndjekjen e praktikës. (Formatet tip janë bashkëngjitur kësaj pakete)

Programi i studimit ka të përcaktuara numrin e krediteve për praktikën mësimore/pedagogjike. Fitimi i kredite munësohet atëherë kur:

- ✓ studentit merr vlerësim pozitiv për dosjen që paraqet për praktikën tek pedagogu i modulit;
- ✓ kur merr vlerësim pozitiv nga mësuesi i institucionit ku ka kryer praktikën;
- ✓ Kur paraqet vërtetimin e firmosur nga titullari i institucionit ku ka kryer praktikën pedagogjike.

### **Frekuentimi i studenteve.**

Frekuentimi i orëve është i detyrueshëm në masën 100%.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES  
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE SOCIALE DHE TË EDUKIMIT

## RELACIONI I PRAKTIKËS

*(Ky raport plotësohet nga studenti që kryen praktikën mësimore/pedagogjike dhe duhet të përmbajë 4 – 5 faqe, shkrimi Times Neë Roman, 12)*

**Emri, mbiemri i studentit:** \_\_\_\_\_

**Emri i programit të studimit:** \_\_\_\_\_

**Emri i institucionit ku ka kryer praktikën:** \_\_\_\_\_

**Kohëzgjatja e praktikës:** \_\_\_\_\_

**Përshkrimi i veprimtarisë së kryer:** *(lloji i veprimtarisë, objektivat, mendimi mbi përvojën e fituar në praktikë, të njohurive të marra gjatë studimeve, përfitimet nga kjo praktikë e kryer, vlerësimi juaj për institucionin arsimor pritës si dhe përfundimet e arritura nga praktika)*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES  
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE SOCIALE DHE TË EDUKIMIT

**FORMULAR I VLERËSIMIT TË PRAKTIKËS  
PEDAGOGJIKE NË EF – 1  
“BACHELOR”**

*(Ky formular vlerësimi plotësohet nga mësuesi mentor i institucionit arsimor që ka asistuar praktikën dhe përmban vlerësimin e studentit sipas përcaktimeve të bëra në programin dhe syllabusin e modulit. Formulari do të dorëzohet tek pedagogu tutor i modulit në përfundim të praktikës pedagogjike.)*

**Emri, mbiemri i studentit:** \_\_\_\_\_

**Emri i programit të studimit: “Shkencat e Lëvizjes”**

**Emri i institucionit ku ka kryer praktikën:** \_\_\_\_\_

**Emri, mbiemri dhe firma e mësuesit që ka drejtuar praktikën:** \_\_\_\_\_

**Emri, mbiemri, firma dhe vula e drejtuesit të institucionit pritës:** \_\_\_\_\_

Kriteret e vlerësimit	Detajimi i pikëve	Pikët e fituara
Punime vëzhguese	20	
Njohje me dokumentacionin shkollor. Vezhgime të orëve mësimore.	30	
Hartimi i planeve tematike	30	
Vezhgimi dhe analizim i orëve mësimore dhe aktiviteteve jashtëmësimore.	20	
<b>Gjithsej:</b>	<b>100</b>	

Tiranë, më \_\_\_\_\_



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES  
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE SOCIALE DHE TË EDUKIMIT

**FORMULAR I VLERËSIMIT TË PRAKTIKËS  
PEDAGOGJIKE NË EF – 2  
“Master Profesional”**

*(Ky formular vlerësimi plotësohet nga mësuesi mentor i institucionit arsimor që ka asistuar praktikën dhe përmban vlerësimin e studentit sipas përcaktimeve të bëra në programin dhe syllabusin e modulit. Formulari do të dorëzohet tek pedagogu tutor i modulit në përfundim të praktikës pedagogjike.)*

**Emri, mbiemri i studentit:** \_\_\_\_\_

**Emri i programit të studimit: “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Shëndetësor në  
Arsimin Parauniversitar”**

**Emri i institucionit ku ka kryer praktikën:** \_\_\_\_\_

**Emri, mbiemri dhe firma e mësuesit që ka drejtuar praktikën:** \_\_\_\_\_

**Emri, mbiemri, firma dhe vula e drejtuesit të institucionit pritës:** \_\_\_\_\_

Kriteret e vlerësimit	Detajimi i pikëve	Pikët e fituara
Punime vëzhguese	10	
Hartimi i planeve tematike.	30	
Organizimi dhe drejtimi i orëve mësimore dhe aktiviteteve jashtëmësimore	40	
Vezhgimi dhe analizim i orëve mësimore dhe aktiviteteve jashtëmësimore.	20	
<b>Gjithsej:</b>	<b>100</b>	

Tiranë, më \_\_\_\_\_



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES  
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE SOCIALE DHE TË EDUKIMIT

**FORMULAR I VLERËSIMIT TË PRAKTIKËS  
PEDAGOGJIKE NË ESH – 3  
“Master Profesional”**

*(Ky formular vlerësimi plotësohet nga mësuesi mentor i institucionit arsimor që ka asistuar praktikën dhe përmban vlerësimin e studentit sipas përcaktimeve të bëra në programin dhe syllabusin e modulit. Formulari do të dorëzohet tek pedagogu tutor i modulit në përfundim të praktikës pedagogjike.)*

Emri, mbiemri i studentit: \_\_\_\_\_

Emri i programit të studimit: “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Shëndetësor në  
Arsimin Parauniversitar”

Emri i institucionit ku ka kryer praktikën: \_\_\_\_\_

Emri, mbiemri dhe firma e mësuesit që ka drejtuar praktikën: \_\_\_\_\_

Emri, mbiemri, firma dhe vula e drejtuesit të institucionit pritës: \_\_\_\_\_

Kriteret e vlerësimit	Detajimi i pikëve	Pikët e fituara
Punime vëzhguese	10	
Hartimi i planeve tematike.	30	
Organizimi dhe drejtimi i orëve mësimore dhe aktiviteteve jashtëmësimore	40	
Vezhgimi dhe analizimi i orëve mësimore dhe aktiviteteve jashtëmësimore.	20	
<b>Gjithsej:</b>	<b>100</b>	

Tiranë, më \_\_\_\_\_



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES  
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE SOCIALE DHE TË EDUKIMIT

## FORMULAR I VLERËSIMIT TË PRAKTIKËS - 4

*(Ky formular vlerësimi plotësohet nga pedagogu tutor mbështetur në vlerësimin e dosjes së dorëzuar nga studenti në përfundim të praktikës. Formulari do të dorëzohet tek pedagogu titullar i modulit në përfundim të praktikës pedagogjike.)*

Emri, mbiemri i studentit: \_\_\_\_\_

Emri i programit të studimit: \_\_\_\_\_

Emri i institucionit ku ka kryer praktikën: \_\_\_\_\_

Emri, mbiemri dhe firma e pedagogu drejtues i ngarkuar për ndjekjen e praktikës:

Kriteret e vlerësimit	Detajimi i pikëve	Pikët e fituara
Vlerësimi i mësuesit mentor	40	
Vlerësimi i planeve tematike të hartuara nga studenti	40	
Vlerësimi i relacionit të hartuar nga studenti	20	
<b>Gjithsej:</b>	<b>100</b>	

Tiranë, më \_\_\_\_\_